

VENDIM
Nr. 263, datë 25.3.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVETË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RISTRUKTURIMI I
UJËSJELLËSIT TË QYTETIT, SI DHE ÇELJA E RRUGËVE “NAIM FRASHËRI”,
“ANDON BULLACI”, “NEVRUZ GJOZA” DHE “ILIRIA”, TË BASHKISË SË BILISHTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rristurimi i ujësjellës të qytetit, si dhe çelja e rrugëve “Naim Frashëri”, “Andon Bullaci”, “Nevruz Gjoza” dhe “Iliria”, të Bashkisë së Bilishtit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Bilishtit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, për sipërfaqen prej 2 754 m² tokë “arë”, në vlerën 1 176 699 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 176 699 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Bilishtit, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Bilishtit.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Bilishtit, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë, prej 2 754 m² tokë “arë”, për rristurimin e ujësjellës të qytetit dhe çeljen e rrugëve, të bëhet në favor të Bashkisë së Bilishtit.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia e Bilishtit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË
SHPRONËSIMIT TË TOKËS ARË, QË DO TË PËRDORET PËR RISTRUKTURIMIN E UJËSJELLËSIT TË
QYTETIT, SI DHE ÇELJEN E RRUGËVE “NAIM FRASHËRI”, “ANDON BULLACI”, “NEVRUZ GJOZA” DHE
“ILIRIA”, BASHKIA BILISHT

Nr	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Sip/m ²	Çmimi/lekë	Vlefte/lekë	Nr. kadastral	Zëri kadastral	Lloji i dokumentit
1	Sadri Hekuran Uzhuri	3804	400	211	84400	1198/13	arë	Vërtetim pronësie
2	Petrit Mete Graca	3804	630	211	132930	1091/22	arë	Vërtetim pronësie
3	Halim Bariq Agolli dhe Muazes Xhemal Agoli	3804	1056	211	222816	1101/11	arë	Vërtetim pronësie
4	Engjellushe Resul Shepi	3804	256	211	54016	1100/23	arë	Vërtetim pronësie
5	Kosta Shefki Pere	3804	117	211	24687	1100/30	arë	Vërtetim pronësie
6	Albert Qamil Nastimi	1187	295	2264	657850	2/272 2/275 2/277	arë	Vërtetim pronësie
Totali			2754		1 176 699			

